

Home > Aktualitet > Kris arma në Tiranë/ 'Problematiku' Klajdi Kodra qëlloi bashkë me vëllain Regin...

AKTUALITET

Kris arma në Tiranë/ 'Problematiku' Klajdi Kodra qëlloi bashkë me vëllain Reginaldo Kaçorrin me plumb në bark, dy fëmijët e nënkampiones së qitjes në ARRATI, policia në ndjekje të tyre

Kush është 'laçjani' që plagosi ditën e sotme 19-vjeçarin, vite më parë i grisi bluzen policit

Ngjarja ndodhi në orën 15:45, në rrugën "Liman Kaba". Dyshohet se ngjarja ka ndodhur pas një konflikti të çastit.



Klajdi Kodra , Redi Kaçorri

27 Maj, 2021 16:00

TIRANË– Redi (Reginaldo) Kaçorri, është 19-vjeçari i cili mbeti i plagosur ditën e sotme në Tiranë. I riu është qëlluar me armë zjarri nga Klajdi Kodra dhe Aldo Kodra (vëllezër) me origjinë nga Laçi. Dy autorët janë fëmijët e nën kampiones së qitjes Lindita Kodra.

Klajdi Kodra, 31-vjeç, rezulton person me precedent të theksuar kriminal, i dënua disa herë më parë për veprat penale "plagosje", "vjedhje", "Armëmbajtje pa leje". Në gusht të 2017, Kodra u arrestua si bashkëpunëtor në atentatin ndaj Loerenc Hoxhës, i cili mbeti i plagosur nga të shtënat. Konflikti ndodhi për hasmëri.

Ngjarja ka ndodhur rreth orës 15:45, në rrugën "Liman Kaba", në afërsi të një lokali. Mësohet se ka pasur përplasje mes dy grupeve, atë të autorit dhe të plagosurit. Sherri fillimisht ka nisur me grushta e shkelma ndërsa më pas ka avancuar në përdorimin e armëve të zjarrit.

Për më shumë bëhu pjesë e grupit më viral në Facebook, [Dosja.al](#)

Drejtori i Policisë së Tiranës, Rebani Jaupaj në një deklaratë për mediat ka dhënë se janë në kërkim të autorit të ngjarjes. Ndërkohë adoleshenti, Redi Kaçorri ndodhet në spitalin e Traumës, nën kujdesin e mjekësve, jashtë rrezikut për jetën.

(a.b)/dosja.al


18:37 - **Plagosja e 19-vjeçarit në Tiranë/ Shpallen në kërkim dy vëllezërit Aldo dhe Klajdi Kodra**

Është identifikuar autori tjetër i dyshuar i plagosje së 19-vjeçarit Reginaldo Kaçorrit pasditën e sotme në Tiranë. Ai është identifikuar si Aldo Kodra, vëllai i Klajdi Kodrës, të dy të shpallur në kërkim për ngjarjen. Me një njoftim për mediat, Policia bën me dije se të dy vëllezërit, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, gjatë një konflikti të çastit kanë qëlluar me armë zjarri 19-vjeçarin.

NJOFTIMI: Identifikohen dhe shpallen në kërkim dy vëllezërit të dyshuar si autorë të plagosjes me armë zjarri të 19-vjeçarit R. K.Në vijim të informacionit të dhënë më parë për plagosjen me armë zjarri të shtetasit R. K., ndodhur rreth orës 15:45, në rrugën "Liman Kaba", në afërsi të një lokali, ju informojmë se: Falë veprimeve të shpejta dhe profesionale hetimore të kryera nga grupi hetimor u bë i mundur identifikimi i autorëve të dyshuar të ngjarjes dhe shpallja në kërkim e tyre. Dyshohet se shtetasi Aldo Kodra, në bashkëpunim me vëllanë e tij shtetasin Klajdi Kodra, gjatë një konflikti të çastit kanë qëlluar me armë zjarri 19-vjeçarin R. K. Grupi hetimor vijon punën për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes. Shërbimet e policisë po ushtrjnë kontrole dhe po krehin zonën për të bërë të mundur kapjen e autorëve.



18:17 - **U qëllua me armë zjarri në bark nga Klajdi Kodra, del fotoja e Reginaldo Kaçorrit**



Reginaldo Kaçorri

Fotoja e 19-vjeçarit, Reginaldo Kaçorrit, i cili mbeti i plagosur me armë zjarri në Tiranë është bërë publike. Ngjarja ndodhi në rrugën "Liman Kaba". I plagosuri është 19-vjeçari Reginaldo Kaçorri nga Rrësheni, person pa precedent penal. Ai është dërguar në spital, ndërsa në vendngjarje ndodhen forcat policore. Ai është plagosur me armë zjarri nga Klajdi Kodra pas një sherri për motive banale.



17:53 - **Si nisi sherri në Tiranë? Klajdi Kodra dhe Redi Kaçorri ishin ulur në tavolinat përballë, dy të rinjtë u konfliktuan verbalisht**

Sherri mes të rinjve që ndodhi ditën e sotme në Tiranë, la pas një person të plagosur dhe një tjetër në kërkim nga policia. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 15:45, në rrugën "Liman Kaba", në afërsi të një lokali. Mësohet se ka pasur përplasje mes dy grupeve, atë të autorit dhe të plagosurit. Sherri fillimisht ka nisur me grushta e shkelma ndërsa më pas ka avancuar në përdorimin e armëve të zjarrit.




16:55 - **'Laçjan/ Qëlloi me armë zjarri 19-vjeçarin në Tiranë, IDENTIFIKOHET autori**

Klajdi Kodra, me origjinë nga Laçi, është autori i plagosjes së 19-vjeçarit në Tiranë. Pas një konflikti për motive të dobëta, Kodra ka nxjerrur armën dhe ka qëlluar në bark, 19-vjeçarin Reginaldo Kaçorrin. Pas ngjarjes autori u largua me shpejtësi teksa policia e ka shpallur në kërkim dhe po punon për kapjen e tij.



16:43 - **Plagosja në Tiranë/ Drejtori i Policisë, Jaupi: Kemi emrin e autorit, po punojmë për arrestimin e tij**

Drejtori i Policisë së Tiranës, Rebani Jaupaj në një deklaratë për mediat ka dhënë disa detaje në lidhje me plagosjen e ndodhur disa minuta më parë në Tiranë. Ai tha se e kanë identifikuar autorin e ngjarjes, e se janë në kërkim të tij. *"Këtu pranë kemi pasur një plagosje me armë zjarri të një 19-vjeçari i cili aktualisht ndodhet në spitalin e Traumës. Është jashtë rrezikut për jetën. Grupi hetimor po punon në vendin e ngjarjes. Ka qenë një konflikt i çastit. Të dyja palët kanë qenë në të njëjtin lokal, fillimisht janë konfliktuar fizikisht. Kanë qenë në tavolinë të veçanta. Një person ka qëlluar me armë zjarri vetëm një herë. Kemi një emër të autorit për të cilin do të bëjmë dokumentimin e plotë të kësaj ngjarje dhe do t'jua bëjmë me dije",* tha Jaupi.



16:26 - **E qëlluan dy persona në Tiranë, zbulohet EMRI i 19-vjeçarit që mbeti i plagosur**


Redi Kaçorri, është 19-vjeçari i cili mbeti i plagosur ditën e sotme në Tiranë. Atentati ndaj tij është kryer në rrugën "Liman Kaba", në afërsi të një lokali. 19-vjeçari është qëlluar me armë zjarri nga dy persona. Dyshohet se shkak mund të jetë bërë një konflikt i çastit, mes të plagosurit dhe autorëve. 19-vjeçari është transportuar në Spitalin e Traumës.



16:19 - **Plagosja e 19-vjeçarit, Policia e Tiranës NJOFTIM zyrtar: Për arsyë të paditura plagoset adoleshenti, po mbledhim çdo provë të kapim dy autorët**

Policia ka dhënë informacionet e para në lidhje me plagosjen që ndodhi në Tiranë këtë pasditë. Policia e Tiranës bën me dije se ngjarja ka ndodhur rreth orës 15:45, në rrugën "Liman Kaba", ku i riu u konfliktua me dy persona të tjerë, ende të paidentifikuar. Sherri degradoi në përdorimin e armëve të zjarrit, ku për pasojë u plagos 19-vjeçari, i cili ndodhet në spital jashtë rrezikut për jetën.

NJOFTIMI: Rreth orës 15:45, në rrugën "Liman Kaba", në afërsi të një lokali, në rrethana ende të paqarta është plagosur dyshohet me armë zjarri shtetasi R. K., 19 vjeç, i cili ndodhet në spital, nën kujdesin e mjekëve. Paraprakisht dyshohet se ngjarja ka ndodhur pas një konflikti të çastit me dy shtetas ende të paidentifikuar nga ana e Policisë. Grupi hetimor ndodhet në vendngjarje dhe po punon për sqarimin e rrethanave të ngjarjes dhe mbledhjen e çdo prove të mundshme që do çojë në identifikimin dhe kapjen e autorëve.



16:11 - **Plagosja e 19 -vjeçarit në Tiranë/ Dy persona qëllojnë drejt të riut në lokal, njëri largohet me 'X5', policia në ndjekje të tyre**

Një person është plagosur ditën e sotme në Tiranë, në zonën e ish-Kompleksit Dinamo. [Dosja.al](#) mëson se kanë qenë më shumë se dy persona të cilët qëlluan drejt një 20-vjeçari. Bëhet e ditur se pas plagosjes një nga autorët është larguar nga lokal me një mjet tip 'x5'.

Për momentin nuk dihet ende identiteti i të plagosur dhe as gjendja e tij shëndetësore. Policia ka shkuar në vendngjarje dhe ka nisur hetimet për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes.



ETIKETA: #klajdi kodra #plagosje me arme ne tirane #redi kacorri

14

SHARES



Previous article

Gjon Muharremaj shprehet i entuziazmuar: I pari nga votat e jurisë dhe i treti nga votat e përgjithshme në Eurovision

Next article

Trazoi qeverinë turke, lëshohet urdhër arresti për Sedat Peker

Shto Koment

Emri Juaj*


E-Mail*

Komenti Juaj*

Dërgo


POSTIME TË NGJASHME

Aktualitet




Plagosja e 19-vjeçarit në Tiranë/ Shpallen në kërkim dy vëllezërit Aldo dhe Klajdi...

Aktualitet




U qëllua me armë zjarri në bark nga Klajdi Kodra, del fotoja e Reginaldo Kaçorrit

Aktualitet



Si nisi sherri në Tiranë? Klajdi Kodra dhe Redi Kaçorri ishin ulur në tavolinat përballë...

Aktualitet



Problematiku Klajdi Kodra! Kush është 'laçjani' që plagosi ditën e sotme 19-vjeçarin...

STAY CONNECTED


f Facebook LIKE

t Twitter FOLLOW

i Instagram FOLLOW

Y Youtube SUBSCRIBE

LAJMET E FUNDIT



27 Maj, 2021 21:22

Studimi i ri/ Shqiptarët të parë në Ballkan për orët e punës në një javë




27 Maj, 2021 21:16

Skandali në spitalin e Fierit/ Mjekët dhunojnë të riun, dalin audiot e regjistruara nga momenti i debatit



27 Maj, 2021 21:15

VIDEO/ Kadare dhe Filokoe, recitojnë Majakovskin së bashku një makinë



27 Maj, 2021 21:13

"Pikant si Edi Rama" dhe "Ndryshim" për PD, njihuni me koktejin e kryeministrit e Berishës

ALE

Aleanca për Media Etike

Artikull joetik?

raporto këtu